




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 07.12.2016

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.11.2016, pas shqyrtimit të propozimit të Nr. 1280, të datës 15.11.2016, paraqitur nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (ç) të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e buxhetit të shpenzuar për nëntëmujorin e vitit 2016 në Komunën e Fushë-Kosovës

1. Për aprovimin e buxhetit të shpenzuar në Komunën e Fushë-Kosovës, për nëntëmujorin e vitit 2016, në shumë të përgjithshme prej 5,281,276.93€.
2. Buxheti i shpenzuar nëpër kategoritë ekonomike është si vijon:
 - 2.1 Për rroga dhe paga buxheti i shpenzuar është në shumë të mjeteve financiare prej 3,290,080.74€;
 - 2.2 Për mallra dhe shërbime buxheti i shpenzuar është në shumë të mjeteve financiare prej 374,338.58€;
 - 2.3 Për shpenzime të komunalive buxheti i shpenzuar është në shumë të mjeteve financiare prej 80,624.11€;
 - 2.4 Për subvencione dhe transfere buxheti i shpenzuar është në shumë të mjeteve financiare prej 280,512.74€ dhe
 - 2.5 Për pasuritë jofinanciare, shpenzime kapitale buxheti i shpenzuar është në shumë të mjeteve financiare prej 1,255,711.76€.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave dhe Buxhetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi, 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.


Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB dhe Arkivës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi**





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 07.12.2016

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.11.2016, pas shqyrtimit të propozimit Nr. 1234, të datës 03.11.2016, paraqitur nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b dhe c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (c dhe ç) të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për rritjen e të hyrave vetjake në buxhetin e Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2016

1. Për rritjen e të hyrave vetjake për vitin fiskal 2016, në shumën prej 185,000.00€, të shpërndara nëpër kategoritë ekonomike të mallrave e shërbimeve dhe subvencioneve e transfereve nëpër kodet e programeve dhe nënprogrameve si në vijim:
 - 1.1 Mjetet financiare, në shumë prej 20,000.00€, lejohen për shpenzim në mallra dhe shërbime, programi i Administratës së Arsimit (92010) në kategorinë ekonomike numër 130;
 - 1.2 Mjetet financiare, në shumë prej 20,000.00€, lejohen për shpenzim në mallra dhe shërbime, programi i Administratës së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (73011) në kategorinë ekonomike numër 130;
 - 1.3 Mjetet financiare në shumë prej 5,000.00€, lejohen për shpenzim në mallra dhe shërbime, programi i Kulturës, Rinisë dhe Sportit (85002) në kategorinë ekonomike numër 130;
 - 1.4 Mjetet financiare, në shumë prej 5,000.00€, lejohen për shpenzim në mallra dhe shërbime, programi i Zyrës së Kryetarit të Komunës (16002) në kategorinë ekonomike numër 130;
 - 1.5 Mjetet financiare, në shumë prej 20,000.00€, lejohen për shpenzim në mallra dhe shërbime, programi i Shërbimeve Publike (18162) në kategorinë ekonomike numër 130;
 - 1.6 Mjetet financiare, në shumë prej 5,000.00€, lejohen për shpenzim në mallra dhe shërbime, programi i Buxhetit dhe Financave (17502) në kategorinë ekonomike numër 130;
 - 1.7 Mjetet financiare, në shumë prej 5,000.00€, lejohen për shpenzim në mallra dhe shërbime, programi i Administratës dhe Personelit (16302) në kategorinë ekonomike numër 130;
 - 1.8 Mjetet financiare, në shumë prej 5,000.00€, lejohen për shpenzim në mallra dhe shërbime, programi i Inspektoratit (16603) në kategorinë ekonomike numër 130;
 - 1.9 Mjetet financiare, në shumë prej 5,000.00€, lejohen për shpenzim në mallra dhe shërbime, programi i Urbanizmit (66015) në kategorinë ekonomike numër 130;

- 1.10 Mjetet financiare, në shumë prej 5,000.00€, lejohen për shpenzim në mallëra dhe shërbime, programi i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (47042) në kategorinë ekonomike numër 130;
- 1.11 Mjetet financiare, në shumë prej 5,000.00€, lejohen për shpenzim në mallra dhe shërbime, programi i Zyrës së Kuvendit të Komunës (16902) në kategorinë ekonomike numër 130;
- 1.12 Mjetet financiare, në shumë prej 5,000.00€, lejohen për shpenzim në mallra dhe shërbime, programi i Zhvillimit Ekonomik(48002) në kategorinë ekonomike numër 130;
- 1.13 Mjetet financiare në shumë prej 5,000.00€, lejohen për shpenzim në mallra dhe shërbime, programi i Kadastrit dhe Gjeodezisë (16902) në kategorinë ekonomike numër 130;
- 1.14 Mjetet financiare, në shumë prej 20,000.00€, lejohen për shpenzim në subvencione dhe transfere, programi i Administratës së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (73011) në kategorinë ekonomike numër 200;
- 1.15 Mjetet financiare, në shumë prej 20,000.00€, lejohen për shpenzim në subvencione dhe transfere, programi i Administratës së Arsimit (92010) në kategorinë ekonomike numër 200;
- 1.16 Mjetet financiare, në shumë prej 15,000.00€, lejohen për shpenzim në subvencione dhe transfere, programi i Kulturës, Rinisë dhe Sportit (85002) në kategorinë ekonomike numër 200;
- 1.17 Mjetet financiare, në shumë prej 15,000.00€, lejohen për shpenzim në subvencione dhe transfere, programi i Zyrës së Kryetarit të Komunës (16002) në kategorinë ekonomike numër 200;
- 1.18 Mjetet financiare, në shumë prej 5,000.00€, lejohen për shpenzim në subvencione dhe transfere, programi i Financave dhe Buxhetit (17502) në kategorinë ekonomike numër 200.
- 2 Mjetet financiare, nga paragrafi 1, nënparagrafet 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6, 1.7, 1.8, 1.9, 1.10, 1.11, 1.12 dhe 1.13 të këtij vendimi, lejohen për mbulimin e shpenzimeve për pagesën e faturave për furnizime me material për zyra, medikamente për shëndetësi dhe derivate të naftës, ndërsa mjetet financiare nga paragrafi 1, nënparagrafet 1.14, 1.15, 1.16, 1.17 dhe 1.18 lejohen për mbulimin e shpenzimeve për ndihmë qytetarëve për shërim dhe terapi shëndetësore, ndihmë studentëve për studime, ndihmë klubeve sportive, ndihmë për shpenzime të ceremonisë së varrimit dhe projekteve të Organizatave Joqeveritare.
- 3 Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit.
- 4 Ky vendim hyn në fuqi, 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës,
Drejtorisë së FB, Drejtorive tjera të Komunës dhe Arkivës.**

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Dr.sc. Fadil Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 07.12.2016


Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.11.2016, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1284, të datës 15.11.2016, paraqitur nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 10, paragrafi 10.2, të Ligjit për Financat e Pushtetit, Nr. 03/L-049, nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim të 'Propozimit për lirim nga taksat për ushtrimin e aktiviteteve biznesore të subjekteve afariste në Komunën e Fushë-Kosovës për vitin kalendarik 2017' dhe dërgimin e tij në procedurën e diskutimit publik

1. Për dërgimin në procedurën e diskutimit publik të ndryshimit të 'Rregullores për tarifa ngarkesa dhe gjoha komunale' Nr. 63, të datës 16.05.2013, duke e shfuqizuar nenin 8 të Rregullores, në funksion të krijimit të lehtësimeve për bizneset ekzistuese dhe avantazhe për hapjen e bizneseve të reja dhe gjenerim të punësimit.
2. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik ka vlerësuar nevojën për lirim nga taksa të bizneseve për vitin kalendarik 2017 dhe do të ofrojë informata e sqarime të nevojshme për opinionin-subjektet afariste, në debatin publik të caktuar më datë: 15.12.2016.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së ZHE dhe Arkivës.




Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA-KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 07.12.2016

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.11.2016, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1239, të datës 04.11.2016, paraqitur nga Njësiti për të Drejtat e Njeriut, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (i), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (f), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim të ‘Projekt-Planit Lokal për Personat me Aftësi të Kufizuara për periudhën pesëvjeçare 2017-2021’ dhe dërgimin e tij në procedurën e diskutimit publik.

1. Për dërgimin në procedurën e diskutimit publik të ‘Projekt-Planit Lokal për Personat me Aftësi të Kufizuara për periudhën pesëvjeçare 2017-2021’.
2. Komisioni i cili ka punuar në hartimin e ‘Projekt-Planit Lokal për Personat me Aftësi të Kufizuara për periudhën pesëvjeçare 2017-2021’ do të ofrojë informata të nevojshme për opinionin-qytetarët e interesuar, shoqatat e personave me aftësi të kufizuara që veprojnë në Komunën e Fushë-Kosovës, në debatin publik të caktuar më datë: 19.12.2016.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoritë e Komunës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorive të Komunës dhe Arkivës.




Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 07.12.2016

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.11.2016, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1275, të datës 14.11.2016, paraqitur nga Zyra Komunale e Komuniteteve dhe Kthimit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim të ‘Projekt-Planit të Veprimit për personat e zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshmepër vitet 2017-2018’ dhe dërgimin e tij në procedurën e diskutimit publik

1. Për dërgimin në procedurën e diskutimit publik të ‘Projekt-Planit të Veprimit për personat e zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme për vitet 2017-2018’.
2. Komisioni i cili ka punuar në hartimin e ‘Projekt-Planit të Veprimit për personat e zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme për vitet 2017-2018’ do të ofrojë informata të nevojshme për opinionin-qytetarët e interesuar, në debatin publik të caktuar më datë 20.12.2016.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, ZKKK-së dhe Arkivës.




Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 07.12.2016

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.11.2016, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 143, të datës 15.11.2016, paraqitur nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, nenin 9, të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës Nr. 62, të datës 16.05.2013 mori:


V E N D I M


Për formimin e ‘Grupit Punues për hartimin e Planit Vjetor të Punës së Komitetit për Politikë e Financa, Komitetit për Komunitete dhe Kuvendit të Komunës për vitin 2017’

1. Për formimin e ‘Grupit Punues për hartimin e Planit Vjetor të Punës së Komitetit për Politikë e Financa, Komitetit për Komunitete dhe Kuvendit të Komunës për vitin 2017’, në përbërje prej nëntë (9) anëtarëve si vijon:
 - 1.1 Fadil Krasniqi - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Kryetar i grupit;
 - 1.2 Miroslav Veličković - Kryesues i Komitetit për Komunitete, anëtar;
 - 1.3 Hasan Gjyrevci - Zyrtar Ligjor për Kuvend dhe Komitete, anëtar;
 - 1.4 Milaim Berjani - Përfaqësues i LDK-së, anëtar;
 - 1.5 Një përfaqësues i PDK-së, anëtar;
 - 1.6 Fitore Simnica - Përfaqësuese e PD-së, anëtare;
 - 1.7 Trandolina Duli - Përfaqësuese e LVV-së, anëtare;
 - 1.8 Ylber Islami - Përfaqësues i pavarur në Kuvendin e Komunës, anëtar;
 - 1.9 Qerim Gara - Përfaqësues i PDAK-së, anëtar.
2. Detyrë e Grupit Punues është ‘Hartimi i Planit Vjetor të Punës së Komitetit për Politikë e Financa, Komitetit për Komunitete dhe Kuvendit të Komunës për vitin 2017’.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Grupit Punues dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 07.12.2016

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.11.2016, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1299, të datës 22.11.2016, paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (g), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (e), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M


Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Njesisë së Zjarrfikësve në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës

1. Për aprovimin e propozimit Nr. 1299, të datës 22.11.2016, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për Njësinë e Zjarrfikësve për territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, në fshatin Bardh i Vogël, në sipërfaqe të përgjithshme prej 1500 m², për ndërtim dhe hapësirë përcjellëse për funksionimin e Njesisë së Zjarrfikësve në Ngastrën Kadastrale Nr. P-72514049-00202-0, e evidentuar në certifikatën e pronës Nr. 25-6265, në vendin e quajtur 'Kod-Dubova', në Zonën Kadastrale Bardh i Vogël, pronë e Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Planifikimit Urban, Drejtorisë së Gjeodezisë, Kadastrit e Pronës dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së PU, Drejtorisë së GJKP, Drejtorisë së SHPM dhe Arkivës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



Datë: 07.12.2016

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.11.2016, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 327, të datës 21.11.2016, paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban, në lidhje me kërkesën Nr. 5290/2016, e datës 04.11.2016, të parashtruar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (e), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (d), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e “Muzeu i Natyrës” në fshatin Sllatinë e Vogël

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 327, të datës 21.11.2016, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e “Muzeu i Natyrës”, në fshatin Sllatinë e Vogël, në sipërfaqe të përgjithshme prej 3 (tre) hektarëve, në Ngastrën Kadastrale Nr. P-72514048-00034-0, e evidentuar në certifikatën e pronës Nr. 25-6251, në vendin e quajtur ‘Suvi-Breg’, në Zonën Kadastrale Sllatinë e Vogël, pronë e Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Planifikimit Urban, Drejtorisë së Gjeodezisë, Kadastrit e Pronës, Drejtorisë së Shërbimeve Publike e Mjedisit dhe Drejtorisë së Kulturës, Rinisë e Sportit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së PU, Drejtorisë së GJKP, Drejtorisë së SHPM, Drejtorisë së KRS dhe Arkivës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi**